

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Valdete Daka dhe Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit H.U., nga fshati G., komuna e S., për shkak të veprës penale shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së dhe keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.1 nënpar.3 të KPK-së, duke vendosur përkritazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit H.U., av. E.R., nga Prizreni, ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.24/2015 datë 24.3.2017, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.294/2017 datë 18.8.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16.4.2018, mori këtë

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit H.U., ANULOHEM aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.294/2017 datë 18.8.2017 dhe çështja i kthehet në rivendosje gjykatës së njëjtë.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.24/2015 datë 24.3.2017, ndaj të dënuarit H.U., është refuzuar akuza në bazë të nenit 389 par. 4 të KPPK-së për vepër penale shpërdorim i pozitës zyrtare apo të autorizimit nga neni 339 par.2 të KPK-së, ndërsa me po të njëjtin aktgjykim i dënuari është shpallur fajtor për shkak të një veprë penale shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së si dhe për një vepër penale keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.1 nënpar.3 të KPK-së dhe është gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 12 muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 9.7.2008 deri më 15.7.2008 e duke ia përcaktuar më parë dënimet për secilën vepër veç e veç. E dëmtuara "A.H.", Administrata Tatimore e Kosovës, për

realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest juridiko-civil, ndërsa i dënuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 400 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.294/2017 datë 18.8.2017 ka pranuar pjesërisht ankesën e mbrojtësit të dënuarit H.U. por edhe sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, vetëm përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale-shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, ashtu që Gjykata e Apelit këtë vepër penale, për të cilën është shpallur fajtor i dënuari, e cilëson si vepër penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. E.R., nga Prizreni, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par.1 nënpar.1.2 lidhur me nenin 384 par.1 nënpar.1.12 dhe nenin 370 par. 7 të KPPK-së dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 432 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së, lidhur me nenin 385 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.nr.196/2017 datë 13.10.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK, dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e bazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit, av. E.R., pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.2 të KPK-së sepse i njëjti është përpiluar në kundërshtim me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPK-së, kjo nga fakti se ky aktgjykim nuk i plotëson kushtet e parapara përkitazi me përmbajtjen dhe formën e aktgjykimit. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë është i paqartë sepse në të njëjtin përveçse theksohet se pjesërisht pranohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit H.U., por edhe sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, vetëm sa i përket cilësimit të veprës penale, nuk theksohet se çka ka ndodhur me pjesën tjetër të aktgjykimit e veçanërisht me sanksionin penal. Po ashtu, në kërkesë pretendohet se në këtë çështje juridiko-penale si fakt vendimtar është dashur të sqarohet pozita zyrtare e të dënuarit H.U. në ndërmarrjen "A.H." si dhe detyrat të cilat rrjedhin nga përkrahimi i vendit të

punës. Kjo nga fakti se është dashur të vërtetohet se a ka qenë i dënuari përgjegjës për pagesën e tatimeve dhe të kontributeve si dhe fakti se në ekspertizë është theksuar se ndërmarrja e cila punon në humbje siç është në rastin konkret, nuk paguan tatim. Më tutje, pretendohet se si palë e dëmtuar cilësohet edhe Administrata Tatimore e Kosovës, edhe pse askund deri më tani ajo nuk është paraqitur si palë e dëmtuar dhe me këtë rast kemi të bëjmë me tejkalimin e aktakuzës.

Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet e cekura në kërkesë si dhe në shkresat e çështjes, gjen se qëndron pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPPK-së e lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK-së, e kjo për arsye se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me arsyetimin e po të njëjtit aktgjykim. Kjo nga fakti se, në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë theksohet se “me pranimin e pjesërishëm të ankesës së mbrojtësit të akuzuarit H.U., por edhe sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, vetëm përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale-shpërdorimi i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 lidhur me par. 1 të KPK-së, ashtu që Gjykata e Apelit këtë vepër penale, për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, e cilëson si vepër penale keqpërdorimi i detyrës zyrtare apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPK-së”, dhe fare nuk ceket se çka ka ndodhur me veprën tjetër penale e posaçërisht me sanksionin penal, siç me të drejtë pretendohet në kërkesë të mbrojtësit.

Nga shkresat e çështjes rezulton se i dënuari H.U. është shpallur fajtor për dy vepra penale dhe se për këto dy vepra penale i janë shqiptuar veç e veç dënimet e përcaktuara si dhe dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej 12 muaj, ndërkaq gjykata e shkallës së dytë fare nuk e thekson në dispozitiv se çka ka ndodhur me sanksionin penal. Kjo e bënë dispozitivin e pakuptueshëm dhe kontradiktor me arsyetimin, andaj kjo Gjykatë gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë si i tillë juridikisht është i paqëndrueshëm.

Gjykata Supreme nuk është lëshuar në shqyrtimin e pretendimeve tjera të paraqitura në kërkesë meqenëse aktgjykimi ishte i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila u cekë më lartë.

Në rigjykim gjykata e shkallës së dytë duhet të eliminojë shkeljet e cekura dhe pas kësaj t'i merr parasysh të gjitha pretendimet ankimore nga ankesa dhe pas shqyrtimit të këtyre të vendosë në mënyrë meritore në këtë çështje penale.

Nga të gjitha këto që u tha më lartë e duke u bazuar në nenin 438 par.1 pika 1.2. të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
PML.nr.281 /2017, më datë 16.4.2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta